




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "Kumanova Cable" Sh.p.k.
Numri Unik Identifikues: 811034066
Pronar: Bashkim Lumi
Operatori i Shpërndarjes: Kumanova Cable Shpk
Adresa: Rr/ Brigada 123, Suharekë



VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes, "Kumanova Cable" SH.P.K, me seli në Suharekë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Operatori i Shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K, me pronarë Bashkim Lumi, është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, me seli në Suharekë. KPM, me datën 27 shtator 2010 Oka marr vendim për dhënie e licencës për Operatorin e Shpërndarjes "Kumanova Cable SH.P.K, me afat prej dhjet (10) viteve për platformën Kabllore dhe me datën 27 shtator 2020, ka marr vendim për ripërtëritjen e saj. Ndërsa, me datën 6 shtator 2018, ka marr vendim për dhënie e licencës për Operatorin e Shpërndarjes "Kumanova Cable SH.P.K, me afat prej dhjet (10) viteve për platformën IPTV.
3. Më datën 16 tetor 2023, pronari, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e KPM-së për Operatorin e Shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K.

Arsyetimi

4. Duke u bazuar në njoftimin e pronarit, për heqje dorë nga licenca e KPM-së në mënyrë vullnetare, Komisioni vlerëson se, ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes "Kumanova Cable SH.P.K.

Vendim

5. Komisioni merr vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës të Operatorit të Shpërndarjes "Kumanova Cable SH.P.K. sipas njoftimit me shkrim për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së.
6. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



10.11.2023

Datë